

ankesa e [REDAKTUAR], pasi që ai nuk ka parashtruar ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 kundër listës së përkohshme të publikuar nga AKP. Neni 127.4 i Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr.02/L-28 thotë se: *“Palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit.”*

Vërejtjet me shkrim i janë dorëzuar ankuesit më 12 tetor 2010. Afati për ankuesin që të parashtrrojë përgjigje ndaj vërejtjeve me shkrim ka skaduar më 22 tetor 2010. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar tek Dhoma e Posaçme.

Më 24 gusht 2010 [REDAKTUAR] (parashtruesi i ankesës nr.2) ka ushtruar ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me të cilën ka kërkuar që të përfshihet në listen e punëtorëve me të drejtë legjitime në ndarjen e të hyrave nga privatizimi. Parashtruesi i ankesës ka deklaruar se në ndërmarrje ka punuar që nga data 7 mars 1994. Më tutje ka theksuar se ai konsideron se në mënyrë të padrejtë nuk është përfshirë në listen e përfundimtare të publikuar më 4 gusht 2010. Parashtruesi i ankesës ka parashtruar edhe kopjen e librezës së punës.

Më datën 13 shtator 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit ka parashtruar në Dhomën e Posaçme vërejtjet me shkrim. AKP-ja ka kërkuar që të hudhet poshtë si e papranushme ankesa e [REDAKTUAR], pasi që ai nuk ka parashtruar ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit sipas nenit 67.2 të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6 kundër listës së përkohshme të publikuar nga AKP. Neni 127.4 i Ligjit mbi Procedurën Administrative Nr.02/L-28 thotë se: *“Palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shteruar mjetet administrative të ankimit.”*

Vërejtjet me shkrim i janë dorëzuar ankuesit më 12 tetor 2010. Afati për ankuesin që të parashtrrojë përgjigje ndaj vërejtjeve me shkrim ka skaduar më 22 tetor 2010. Asnjë përgjigje nuk është parashtruar tek Dhoma e Posaçme.

Më 27 janar 2011 Dhoma nepërmjet Urdhërit nga AKP-ja ka kërkuar, publikimet origjinale të listës së përkohshme dhe listës përfundimtare të të punësuarve me të drejta legjitime në dy ditë pune.

Më 07 shkurt 2011 AKP-ja ofron përgjigje me të gjitha të dhënat e kërkuara në urdhër

Faktet:

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e shpalli valën e 18-të të privatizimit përmes së cilës Ndërmarrja Shoqërore [REDAKTUAR] nga Gjilani ishte privatizuar me procedurën e rregullt spin off. Asetet dhe detyrimet ishin transferuar tek Kompania e Re L.L.C. Më 15 maj 2007, kontrata e shitblerjes së privatizimit ishte ratifikuar dhe kishe hyrë në fuqi.

Më 4, 5 dhe 7 gusht 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Serbe “Vijesti” nga

Podgorica, Mali i Zi (provë: korespodenca mes zyrtarit të agjencisë dhe departamentit për marketing të gazetës në fjalë).

Më 4,5 dhe 7 gusht 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Serbe “Blic” nga Beogradi, Serbi.

Më 5, 6 dhe 7 gusht 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Shqipe “Infopress” nga Prishtina (provë: nuk është kundërshtuar, kopjet e publikimeve).

Më 5, 6 dhe 7 gusht 2010, Agjencia Kosovare e Privatizimit e ka publikuar listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar në gazetën në gjuhën Shqipe “Koha Ditore” nga Prishtina (provë: korespodenca mes zyrtarit të agjencisë dhe departamentit për marketing të gazetës në fjalë).

Afati i fundit për paraqitjen e ankesave pranë Dhomës së Posaçme, në pajtim me Nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 ka kaluar më datën 30 gusht 2010. Dhoma e Posaçme i ka regjistruar 2 (dy) ankesa ku kërkohet përfshirja në listën përfundimtare të punëtorëve të kualifikuar të përpiluar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit.

Ankuesi [REDAKTUAR] ka punuar në Ndërmarrjen Shoqërore të privatizuar [REDAKTUAR] nga Gjilani prej datës 10 qershor 1996. (provë: kopja e librezës së punës).

Ankuesi [REDAKTUAR], Viti ka punuar në Ndërmarrjen Shoqërore të privatizuar [REDAKTUAR] nga Gjilani prej datës 7 mars 1994. (provë: kopja e librezës së punës).

Ndërmarrja Shoqërore [REDAKTUAR] veprimtaria kryesore e të cilës ishte nxjerrja e gurëve dhe zhavorrit të fraksioneve të ndryshme, si dhe shitja, transporti dhe vendosja e zhavorit në lokacione të ndryshme, pas qershorit të vitit 1999 ka punuar me kapacitet jo të plotë (60 %). Në ndërmarrje kanë punuar vetëm 26 punëtor, gjersa pjesa tjetër e punëtorëve ishin në pushim pa pagesë.

Neni 67.10 i Udhëzimit Administrati 2008/6 thekson se :

“Seanca gojore mbahet nese ankuesi ose i padituri kërkon me shkrim që ajo të mbahet ...”

Meqenëse asnjëra palë nuk e ka kërkuar këtë dhe lista nuk është kundërshtuar nga askush trupi gjykues vendosi për lëshimin e ktgjykimit për këtë qështje ,pa seancë gojore.

Arsyetimi ligjor

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë bëhet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit e themeluar me Ligjin Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 03/L-067).

Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13 e rregullon transformimin e së drejtës për përdorimin e pronës së patundshme në pronësi shoqërore. Neni 10 i Rregullores në fjalë saktëson statusin e të punësuarve në ndërmarrje shoqërore dhe ndikimin e privatizimit në këtë status.

Nenet 10.2 dhe 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 e përcaktojnë procedurën për tu zbatuar nga Agjencia për sa i përket përpilimit të listës së punëtorëve të kualifikuar. Fillimisht, organi përfaqësues i punëtorëve të ndërmarrjes, në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, e harton në bazë jodiskriminuese listën e punëtorëve me të drejta legjitime dhe më pas ia dërgon atë Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Agjencia e shqyrton listën dhe i bën ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë punëtorët me të drejta legjitime në fondet që duhen shpërndarë. Më pas, në pajtim me Nenin 67.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, publikohet lista e përkohshme, bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrorë ankesë në këtë Agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët e gëzojnë të drejtën e përfitimit të një pjese të ardhurave nga privatizimi. Përfundimisht, në pajtim me Nenin 67.5 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, pasi t'i ketë shqyrtuar të gjitha kërkesat dhe kundërshtimet, e Paditura do ta rregullon listën e punëtorëve me drejtë legjitime, nëse është e nevojshme, në përputhje me rrethanat, dhe me aktvendimin e Bordit të Drejtorëve të tij në pajtim me Nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, që duhet të përmbajë një justifikim të arsyetuar për përfshirjen apo mospërfshirjen të secilit person në listën e pranimit ose refuzimit e kundërshtimeve të tjera në listë, zyrtarisht ta përpilojë listën e punëtorëve me të drejta legjitime. Lista e punëtorëve me të drejta legjitime e përpiluar si e tillë duhet të publikohet në pajtim me Nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.

Sipas kësaj të gjithë ata të cilët nuk janë përfshirë në listen e punëtorëve me të drejta legjitime mund të kërkojnë që të përfshihen në këtë listë brenda afatit të paraparë duke dorëzuar kërkesën më së pari në AKP. Vetëm pas shqyrtimit të kërkesave nga AKP-ja që kanë të bëjnë me listen e punëtorëve palët mund t'i drejtohen Gjykatës.

Neni 127.4 I Ligjit mbi Procedurën Administrative thekson se “palët e interesuara mund t'i drejtohen gjykatës vetëm pasi të kenë shterur mjetet administrative të ankimit”. Nga shkresat e lëndës të siguruara nga AKP-ja Dhoma gjen se palët nuk e kanë shfrytëzuar këtë mjet juridik për të realizuar të drejtat e veta .

Neni 67.2 të UA të UNMIK-ut 2008/6 thotë: “Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrorë ankesë në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.”

Afati i fundit kohor për parashtrimin e ankesës pranë AKP-së kundër listës së përkohshme ka përfunduar më 15 gusht 2009. Ankuesit nuk kanë parashtruar asnjë ankesë pranë AKP-së kundër listës së përkohshme.

Megjithatë, afati i fundit kohor i caktuar me anë të Nenit 67.2 të përmendur më sipër nuk i referohet një afati kohor procedural pranë Dhomës së Posaçme, por i referohet vetëm procedurës së brendshme administrative e cila do të merret në konsideratë nga AKP-ja me rastin e vlerësimit të ankesave kundër listës së përkohshme.

Mos parashtrimi i ankesës brenda afatit kohor kundër listës së përkohshme të AKM-së, në bazë të çfarëdo rregulle procedurale të paraparë në bazë të UA 2008/6 të UNMIK-ut, nuk bartë si pasojë pranueshmërinë e ankesës së parashtruar pranë Dhomës së Posaçme kundër listës përfundimtare.

UA 2008/6 e UNMIK-ut përmban dispozita specifike procedurale në lidhje me procedurën para Dhomës së Posaçme dhe si të tillë mbizotërojnë dispozitat e tjera të përgjithshme (*lex specialis derogat legi generali*).

Për më tepër, duhet të merret në konsideratë se pas parashtrimit të ankesës, Dhoma e Posaçme ka të drejtën e kontrollimit të listës dhe të verifikojë të drejtën e ankuesit për t'u përfshirë në listën përfundimtar të punëtorëve me të drejta legjitime. Kjo mund të interpretohet në atë kuptim që Gjykata ka autoritetin për të verifikuar kërkesat e ankuesit në lidhje me pranueshmërinë e tij/saj për përfshirje apo jo në listë, pavarësisht faktit nëse ka parashtruar apo jo një ankesë pranë AKP-së kundër listës së përkohshme. Me fjalë të tjera, pas skadimit të afatit të fundit kohor për procedurë administrative pranë AKP-së, nuk mund t'i mohohet ankuesit që të mbrojë të drejtën e tij pranë Gjykatës.

Për këto arsye, Dhoma e Posaçme vendos që ankesat, të cilat janë parashtruara nga punëtorët që nuk kanë respektuar afatit administrativ të datës 15 gusht 2009 për parashtrimin e ankesës pranë AKP-së kundër listës së përkohshme (apo të cilët asnjëherë nuk kanë parashtruar ndonjë ankesë drejtpërdrejtë pranë Dhomës së Posaçme), janë të pranueshme.

Nenet 10.4 dhe 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 i përcaktojnë kërkesat të cilat duhen plotësuar nga një punëtor për t'u konsideruar me të drejta legjitime për listën e të punësuarve me të drejta legjitime. Neni 10.4 shprehimisht thekson se punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri vite....

Ankuesit në Ankesat e veta nuk kanë ofruar asnjë provë materiale me të cilën ata do të dëshmoni se i plotësojnë kushtet e kërkuar nga neni i cekur më lartë, se ka qenë në listën e pagave në kohën e privatizimit për jo më pak se tri vite dhe se të njëjtit nuk kanë theksuar se janë larguar nga puna për shkak të diskriminimit apo për shkaqe pasigurie nuk kanë mundur që të paraqiten në vendin e tyre të punës.

Librezat e punës të ofruara nga ankuesit nuk mund të konsiderohen si dëshmi se të njëjtit kanë qenë në marrëdhënie pune në momentin e fillimit të privatizimit si parashef neni 10.4 i Rregullores 2003/13 aq më tepër kur kemi parasysh faktin se ndërmarrja në fjalë që nga viti 1999 punon me kapacitet prej 60 % me vetëm 26 punëtorë, pjesa tjetër e

punëtorve sipas dëshmive të ofruar nga Agjencia ka qenë në pushim pa pagesë. Në të vërtetë, emrat e parashtruesve të ankesave nuk janë të regjistruar në librin amë (shih kopjen e bashkangjitur nga AKP- ja) dhe ata nuk kanë përmendur ndonjë arsye për këtë situatë (edhe pse librezat e punës janë të hapura nga të dhënat e Agjencisë nuk është provuar se ka pasur marrëdhënie pune në kohën e privatizimit).

Nisur nga kjo që u tha më lart dhoma vendosi që Ankesat e parashtruesve të ankesave [redacted] Vit të refuzohen si të pa bazuara .

Në pajtim me Rregullat Plotësuese Procedurale të Dhomës së Posaçme në lidhje me taksat gjyqësore në fuqi prej datës 10 mars 2010 (në bazë të nenit 57.2 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6) procedura në lëndët në lidhje me Listën e Punëtorëve me të Drejta Legjitime (Neni 67 i UA-së së UNMIK-ut 2008/6) është pa pagesë. Prandaj, nuk duhej të merrej vendim për taksat gjyqësore.

Këshillë Ligjore

Në pajtim me nenin 9.5 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4 ankesa kundër këtij aktgjykimi mund t'i ushtrohet me shkrim Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi.

Piero Leanza, Gjyqtar Kryesues,
EULEX (nënshkrimi)

Laura Plesa, Gjyqtare,
EULEX (nënshkrimi)

Ilmi Bajrami, Gjyqtar (nënshkrimi)

Tobias Lapke, Regjistruer,
EULEX (nënshkrimi)